

# DITURIA

E PËRKOHËSHMË SHQIPËTARE

*Del një herë në muaj*

---

DREJTONJËS: LUMO SKENDO

---

MBAN:

*Shqipëtarët në Greqi — Një meshë shqip në Berat — Aktiviteti i Shqipëtarëve në Rumani — Jeta ekonomike shqipëtare — Ilyri dhe Epir i vjetër dhe Shqypni e re — Shoqëri e Stambollit — Bibliografi — Bibliografi shqipëtare.*

---

TIRANË  
LIBRARIJA LUMO SKENDO  
1926

## Këndonjësvet

**S'**kemi marrë më parë pajtimet e DITURISË nga shkakut se donim të sigurohemi në do të mundim t'a nxierim me regull të përkohëshmen tënë, të dimë sa pajtimtarë do të kemi.

Numuri i nënëshkrimevet që na kan ardhur, dhe premtimet e pajtimevet, na dukenë të mjaftë për nevojat e revistësë.

Me gjithë këtë s' do haruarë se një e përkohëshme ka nevoja të mbëdha për të holla që të munt të shtypetë dhe të botohetë. Pandaj u lutemi këndonjësvet, zotërinjvet dhe miqvet që na dërguanë nënëshkrimin e tyre, të kenë mirësinë të na dërgojnë pajtimin dhe të mundohenë që të na dërgohen' edhe ndihmat e miqvet të tyre.

Do mbajturë mënt se, jeta e revistësë dhe regulla e saj në të botuarë, do të sigurohenë me pajtimet që do të na vijnë.

Pajtimi i së përkohëshmes sënë është 10 franga ar, për tekdo në Shqipëri.

Kjo sumë munt të çohetë me mandat postar, ose brënda në letrë, duke vënë plikun në postë me vleftë të deklaruarë.

Jashtë Shqipërisë pranojmë vetëm franga të Svicrësë (10) ose dollarë (2).

Adresa jone, për pajtime dhe çdo send, është:

LIBRARIJA LUMO SKENDO  
TIRANË

**SHËNIM** — Po vazhdojmë t' u dërgojmë edhe këtë numur të dytë atyre zotërinjve që na dërguan nënëshkrimin.

Atyreve që nukë do të duanë të pajtohenë u lutemi shumë të na kthejnë numurin e parë dhe të dytin, që të mos mbesë mangut koleksioni.

